



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2186/ 11 prot.

Datë 30/10/2025

V E N D I M
Nr. 1565/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30/10/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1445/2025, datë 14.10.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-54798-07-15-2025, me objekt “Blerje orendi dhe pajisje mobilimi” për Drejtorinë e përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”, me fond limit 2,488,363 (Dy milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Bashkimi i operatoreve ekonomike “Bajro Bros” SHPK & “Muça” me NIPT M113130290 me adresë Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, Njësi Shërbimi Nr.1017 , Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Eduard Xhixha” PF me NIPT L54424205B me adresë, Ndertese private, 2 katëshe, kati parë mbi tokë, zona kadastrale nr. 3096, me numër pasurie 97/32/1, Qerek, Nikël, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 14.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1445/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Bajro Bros” SHPK & “Muça” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-54798-07-15-2025, me objekt “Blerje orendi dhe pajisje mobilimi” për Drejtorinë e përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”, me fond limit 2,488,363 (Dy milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti Kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, duke kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Bajro Bros” SHPK & “Muça” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2137/10 prot., datë 27.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2186/9 prot., datë 29.10.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1445/2025, datë 14.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-54798-07-15-2025, me objekt “*Blerje orendi dhe pajisje mobilimi*” për *Drejtorinë e përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit*”, me fond limit 2,488,363 (Dy milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2137/10 prot., datë 27.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2186/9 prot., datë 29.10.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1445/2025, datë 14.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-54798-07-15-2025, me objekt “*Blerje orendi dhe pajisje mobilimi*” për *Drejtorinë e përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit*”, me fond limit 2,488,363 (Dy milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1445/2025 datë 14.10.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Bajro Bros*” SHPK & “*Muça*” SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1445/2025, datë 14.10.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-54798-07-15-2025, me objekt “Blerje orendi dhe pajisje mobilimi” për Drejtorinë e përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”, me fond limit 2,488,363 (Dy milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

